



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 97, datë 30.09.2020

MBI

MIRATIMIN PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË GODINËS 1 KT, QË I PËRKET SHKOLLËS SË VJETËR 9-VJEÇARE “RIZA SHERA”, RADË, NJËSIA ADMINISTRATIVE MANËZ, QË MBAN NR. 07, TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, QË ME VKM NR. 538, DATË 7.8.2012, BËN PJESË NË LISTËN PARAPRAKE TË PRONAVE TË BASHKISË MANËZ (SOT BASHKIA Durrës), PËR SHKAK SE ËSHTË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E DATËS 26 NËNTOR 2019 DHE PËRBËN RREZIK SHUMË TË LARTË PËR JETËN DHE SHËNDETIN, DHE REKOMANDOHET TË DEMOLOHET, KJO SIPAS AKTEKSPERTIZËS SË THELLUAR, REALIZUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË, DHE MIRATIMIN PËR HEQJEN NGA KONTABILITETI DHE LISTA PARAPRAKE E PRONAVE, TË GODINËS SË SHKOLLËS 9-VJEÇARE “RIZA SHERA”, QË MBAN NR.07, TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, ME VENDODHJE NË RADË, NJËSIA ADMINISTRATIVE MANËZ, QË ME VKM NR. 538, DATË 7.8.2012, BËN PJESË NË LISTËN PARAPRAKE TË PRONAVE TË BASHKISË MANËZ (SOT BASHKIA Durrës)

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, Vendimit nr. 500, datë 14.8.2001, të Këshillit të Ministrave “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr.538, datë 7.8.2012 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Manëz, të Qarkut Durrës”, VKM-së nr. 796, datë 11.12.2019 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar

vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, shkresës nr.1376 Prot., datë 16.06.2020, ardhur nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, me lëndë “Dërgim Akt ekspertize”, ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK V E N D O S I :

1. Miratimin për prishjen e detyruar të godinës 1 KT, që i përket shkollës së vjetër 9-vjeçare “Riza Shera”, Radë, Njësia Administrative Manëz, Bashkia Durrës, për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 Nëntor 2019 dhe përbën rrezik shumë të lartë për jetën dhe shëndetin, dhe është rekomanduar të priset, kjo sipas aktekspertizës së thelluar, e kryer nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.
2. Miratimin për heqjen nga lista paraprake e pronave të Njesisë Administrative Manëz, Bashkia Durrës, të pronës me nr.07, me vendodhje në Radë, që i përket shkollës së vjetër 9-vjeçare “Riza Shera”, Radë, që me VKM nr.538, datë 7.8.2012, bën pjesë në listën paraprake të pronave të Bashkisë Manëz (sot Bashkia Durrës).
3. Drejtoria Ekonomike, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në zbatim të ligjit nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditësimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e Pasurive të Paluajtshme Durrës, të pronës me emërtimin “godina e vjetër e shkollës 9-vjeçare “Riza Shera”, Radë, Njësia Administrative Manëz, që me VKM nr.538, datë 7.8.2012, bën pjesë në listën paraprake të pronave të Bashkisë Manëz (sot Bashkia Durrës).
4. Toka (trualli) i liruar nga prishja e godinës, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, nëse i plotëson kushtet për ndërtim (pasi të studiohet për kushtet gjeologjike dhe sizmike), të përdoret për ndërtimin e godinës me destinacion arsim parashkollor (kopsht për fshatin Radë, Njësia Administrative Manëz).
5. Shpenzimet për shembjen e godinës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të mbulohen nga institucionet përkatëse, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Durrës.

6. Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të bashkërendojnë punën me Njësinë Zbatuese (Fondin e Zhvillimit), që administron fondet për rindërtim, që transferohen nga Këshilli i Ministrave, prej fondit të rindërtimit, për të realizuar ndërtimin e godinës me destinacion arsim parashkollor (kopsht për fshatin Radë, Njësia Administrative Manëz), si dhe përfshirjen në listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të ndërtesës, pas realizimit të ndërtimit.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme Ligjore dhe Drejtoria e Shërbimeve dhe Punëve Publike.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.09.2020






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 899/19 prot.

Durrës, më 02.10.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 97 datë 30.09.2020 “Mbi miratimin për prishjen e detyruar të godinës 1 kt, që i përket shkollës së vjetër 9-vjeçare “Riza Shera”, Radë, njësia administrative Manëz, që mban nr. 07, të listës së transferimit, që me VKM nr. 538, datë 7.8.2012, bën pjesë në listën paraprake të pronave të bashkisë Manëz (sot bashkia Durrës), për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019 dhe përbën rrezik shumë të lartë për jetën dhe shëndetin, dhe rekomandohet të demolohet, kjo sipas aktekspertizës së thelluar, realizuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, dhe miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista paraprake e pronave, të godinës së shkollës 9-vjeçare “Riza Shera”, që mban nr.07, të listës së transferimit, me vendodhje në Radë, njësia administrative Manëz, që me VKM nr. 538, datë 7.8.2012, bën pjesë në listën paraprake të pronave të bashkisë Manëz (sot bashkia Durrës)”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

